



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:051496
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05804534

KP.nr. 7/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “Far Logistics” Sh.p.k, me NUI 81147109, me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit “Hym Logistics” L.L.C., me NUI 812004547, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Ahmet Tahiri, me objekt kontesti kompensim dëmi për shkak të konkurrencës jolojale, duke vendosur sipas parashtrësës së paditësit për tërheqjen e padisë, jashtë seance me datën 10.06.2024 merr këtë :

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia e paditësit “Far Logistics” Sh.p.k, e ushtruar më datën 27.02.2023, kundër të paditurit “Hym Logistics” L.L.C., për kompensim dëmi për shkak të konkurrencës jolojale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tijë më datën 27.02.2023, pranë kësaj ka ushtruar padi ndaj të paditurit “Hym Logistics” L.L.C., me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të konkurrencës jolojale.

Paditësi përmes parashtrësës së datës 06.06.2024, i është drejtuar kësaj gjykate, dhe ka kërkuar që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit, pasi që me të paditurit kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Gjykata kishte caktuar seancë më datën 10.06.2024 me fillim në ora 13.30, dhe palët janë ftuar në mënyrë të rregullt, fakt i cili është vërtetuar nga fletë kthesa për dorëzim personal, i autorizuari i paditësit avokati Driton Musliu përmes parashtrësës së datës 05.06.2024 e ka denoncuar

autorizimin dhe e ka njoftuar gjykatën se pala është njoftuar për seancën e caktuar, në seancën e datës 10.06.2024, kishte prezantuar vetëm i autorizuari i të paditurës i cili është njoftuar për parashtrësën për tërheqje të padisë dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar.

Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës për tërheqje të padisë, konstatoj se paditësi po e tërheq padinë, andaj në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.7/23, datë 10.06.2024

Gjyqtari
Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.